

20111854143

L I G J
PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM-BANKA BOTËRORE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM TË PROJEKTIT PËR SIGURIM NGA
KATASTROFA NATYRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka Nderkombetare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore në shume prej 5 000 000 dollarësh amerikanë, të dedikuar për realizimin e Projektit për sigurim nga katastrofat natyrore.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për Projektin për sigurim nga katastrofa natyrore, që do të lidhet ndermjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Nderkombetare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati i pagimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është 22 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej gjashtë vitesh.

Shkalla e kamatës është LIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile (për valutë dollarë amerikanë).

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Nderkombetare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore provizion të njehershëm në shumë prej 0,25 % nga shuma e huas.

Huaja do të paguhet në 32 këste gjysmëvjetore, në çdo 15 maj dhe 15 nëntor të vitit. Nga 15 maji 2017 deri më 15 maj 2032 do të paguhet 31 këste gjysmëvjetore secili në shumë prej 3,13% nga shuma e huas, kurse më 15 nëntor 2032 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 2,97% nga shuma e huas.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Financave. Projektin do ta implementojë Agjencia për Supervizion të Sigurimit.

Neni 5

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".